



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Sociolinguistikë**

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 30 leksione / 10 seminare
Viti / Semestri : Viti III . semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva të përgjithshme:

Studenti duhet të jetë i aftë: të dijë ta vendosë Sociolinguistikën në brendësi të shkencave të ligjërimit. të njohë nocionet kryesore si dhe njësitë e analizës themelore, të bazuara mbi konceptin e varietetit sociolinguistik. të ndërgjegjësohet për raportin gjuhë-shoqëri duke analizuar ndërlidhjet midis karakteristikave gjuhësore strukturale edhe variablave extragjuhësore të natyrës sociale e funksionale. të fitojë njohuri specifike në lidhje me situatën sociolinguistike italiane. të njohë vlerën e diversitetit dhe kompleksitetit gjuhësor si elementë bazë të shoqërisë bashkëkohore, e përmblytur nga teknologjitë e komunikimit si dhe nga përdorimi i mediave të reja.

Objektiva të veçantë:

1. Të jetë i aftë për përfitim nga ana e studentit e një panorame të përgjithshme të përdorimit të gjuhës nga ana e operatorëve të saj në Itali.
2. Të jetë i aftë për marrjen e disa njohurive elementare mbi dialektet dhe të folmet italiane.